

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-627 HP

LLAÇ ME PERFORMANCË TË LARTË, ME 1 PËRBËRËS PËR APLIKIM MANUAL OSE ME SPËRKATJE PËR PUNIME RIPARIMI TË BETONIT NË TRASHËSI TË MADHE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-627 HP është llaç me bazë çimentoje gati për përdorim, me mpiksje të shpejtë, tkurrje të ulët dhe i përforcuar me mikrofibra të posaçme sintetike për riparime betoni me kërkesa të larta në trashësi të madhe aplikimi manual ose me teknikën e spërkatjes së lëngët, i cili plotëson kërkesat e kategorisë R4 të EN 1504-3.

PËRDORIMET

- Riparime strukturore të elementeve prej betoni me performancë dhe trashësi të madhe
- Aplikim manual (me mallë) dhe me spërkatje
- Riparime me performancë qëndrueshmërie të lartë (infrastruktura, viadukte, beton subjekt i ekspozimit të rëndë mjedisor)
- Ideal për punime riparimi përpara aplikimit të sisteme FRP për përforcim strukturor Sika® Carbodur ose SikaWrap®
- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, Metoda 3.1 & 3.3, EN 1504-9). Riparimi i betonit të thyer dhe të dëmtuar në ndërtesa, ura, vepra infrastrukturore dhe superstrukturore.
- I përshtatshëm për përforcimin e strukturave (Parimi 4, Metoda 4.4, EN 1504-9). Shtim i kapacitetit bartës të strukturës prej betoni duke hedhur llaç.
- I përshtatshëm për ruajtje dhe rivendosi të pasivitetit (Parimi 7, Metoda 7.1 & 7.2, të EN 1504-9). Shtim i mbulimit me llaç ose beton shtesë ose duke zëvendësuar betonin e kontaminuar apo të karbonuar.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kategoria R4 sipas EN 1504-3
- Për trashësi aplikimi midis 15 mm dhe 80 mm me aplikim manual (për shtresë) ose deri në 100mm me spërkatje të lëngët
- Mpiksje e shpejtë pa tkurrje (reduktim thelbësor i kohëve të punës)
- Rezistencë e lartë ndaj ngjeshjes në kohë të shkurtër pas mpiksjes
- Ndërkapje e jashtëzakonshme mbi beton dhe nënshtresa të ndryshme
- Punueshmëri dhe tiksotropi e shkëlqyer
- Rezistencë tepër e lartë kundër hyrjes së klorureve dhe sulfateve, për riparime me rezistencë të përmirësuar
- Testuar në kombinim me sistemet FRP të përforcimit strukturor Sika® Carbodur dhe SikaWrap®
- Kontribut në qëndrueshmërinë (sustainability) të ndërtesave (pajtueshmëri me modelin EPD)

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Sika MonoTop®-627 HP mbulohet nga Modeli EPD "Llaçe minerale të modifikuara, grupi 1", Numër Deklarimi EPD-FEI-20160017-IBG1-EN

MIRATIME / STANDARDE

Llaç riparimesh CC për riparim strukturor të ndërtesave dhe veprave të inxhinierisë së ndërtimit, Kategoria R4 sipas EN1504-3:2005. Parimet 3, 4 & 7, Metodat 3.1 & 3.3, 4.4, 7.1 & 7.2 sipas EN1504-9:2008. Deklaratë Performance 35471520 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura dhe aditivë
Ambalazhi	thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri me fibra

Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit		
Kushtet e magazinimit	Në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga lagështia.		
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2.15 kg/lit	(EN 1015-6)	
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 4.0 mm		
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤0.05%		(EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	1 ditë	7 ditë	28 ditë	Kërkesat (R4)	(EN 12190)
	≥ 20 MPa	≥ 40 MPa	≥ 52 MPa	≥ 45 MPa	
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	Rezultatet		Kërkesat		(EN 13412)
	~ 27.30 GPa		≥ 20 GPa		
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	1 ditë	7 ditë	28 ditë		(EN 196-1)
	≥ 4 MPa	≥ 6 MPa	≥ 8 MPa		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥2.0 MPa				(EN 1542)
Tkurrja / bymimi i kontrolluar	≥2.0 MPa				(EN12617-4)
Aplikim tavanor	≥2.0 MPa				(EN 13395-4)
Reagimi ndaj zjarrit	A1 (Euroclass)				
Rezistenca ndaj sulfateve	Pa disagregim mostre pas 365 ditësh i zhytur në tretësirë sulfat magnezi (MgSO ₄ 63 g/l)				(ASTM C1012)
Absorbueshmëria kapilare	≤ 0.5 kg /m ² h ^{0.5}				(EN 13057)
Hyrja e joneve të klorureve	< 0.02%*				(EN 13396)
	* Pas 6 muajsh në thellësi 10 mm				
Rezistenca ndaj karbonimit	dk ≤ beton kontrolli (MC (0.45))				(EN 13295)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Sika MonoTop®-627 HP është pjesë e serisë së llaçeve Sika që plotëson pjesën përkatëse të Standardit European EN 1504 dhe përbëhet nga:

Prajmer / Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës

Sika MonoTop®-910 N

SikaTop Armatec®-110 EpoCem®

Llaç meremetues

Sika MonoTop®-627 HP

Llaç nivelues

Sika MonoTop®-621 Evolution

Sikagard®-720 EpoCem®

Kërkesat (R4)

Përdorim normal (EN 1504-7)

Kërkesa të larta (EN 1504-7)

Llaç i kategorisë R4 për riparim betoni manualisht & me makineri

Izolues poresh & llaç nivelues (EN 1504-2)

Kërkesa të larta (EN 1504-3 & EN 1504-2)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	3.3 - 3.9 lt ujë për thes 25kg
Konsumimi	~ 1.80 kg/m ² /mm, në varësi të ashpërsisë dhe trashësisë së shtresës së aplikuar
Trashësia e shtresës	15-80 mm aplikim manual; prisni të paktën 10 min. midis veshjeve. 15-100 mm aplikim me spërkatje të lëngët
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.
Koha e punueshmërisë	~ 20 min. (+20°C)

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Betoni:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë plotësisht e pastruar dhe pa pluhur, pislleqe dhe materiale të lira, kontaminime të sipërfaqes si vaj apo graso, kore çimentoje që redukton ngjitjen ose parandalon përthithjen apo lagjen. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes duhet të jetë >1.5MPa. Betoni i shpetëzuar, i dobët dhe i shkatërruar dhe kudo nevojitet edhe betoni i shëndetshëm - por jo deri në dëmtim të integritetit strukturor - duhet të hiqet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si pastrimi me ujë në presion të lartë ose me fryrje rëre. Nuk preferohen metoda pastrimi me vibrim. Ashpërsioni sipërfaqen e betonit në thellësi deri në 2 mm për të ekspozuar agregatet, në përputhje me EN 1766 ose CSP 5 nga Udhëzimet ICRI. Skajet e zonës së ndikuar duhet të priten në mënyrë përpjendikulare (90 gradë) në thellësi min. deri në 5 mm. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes duhet të jetë >1.5 MPa. Ndiqni udhëzimet e dhëna nga supervizori ose një inxhinier i kualifikuar.

Armatura prej çeliku:

Sipërfaqja prej çeliku nuk duhet të ketë ndryshk, smërç, llaç, mbetje betoni, vaj, graso, pluhur dhe materiale të tjera të lira të cilat mund të reduktojnë ngjitjen ose mund të shkaktojnë korrodin. Në rast ndryshku, pastroni në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë sipërfaqen e shufrave prej çeliku (ku është e mundur) duke përdorur teknika pastrimi abraziv ose rrymë uji në presion të lartë deri në Sa 2½ në përputhje me ISO 8501-1. Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara aplikimit të llaçit.

Kallëpi:

Çdo kallëp duhet të ketë kapacitetin për të përballuar forcat që i ushtrohen. Kallëpi duhet të jetë i pastër dhe i vendosur në pozicion pas përgatitjes së nënshtresës dhe armaturës. Disarmantët si seria Sika® Separol®, duhet të aplikohen përpara vendosjes në pozicion për të shmangur kontaktin me nënshtresën e përgatitur. Referohuni gjithashtu edhe tek EN1504-10 për kërkesa specifike.

PËRZIERJA

Sika MonoTop®-627 HP mund të përzihet me mikser manual në shpejtësi të ulët (~500 r.p.m.). Hidhni ujin në raportin e saktë të dëshiruar brenda një ene të përshtatshme për përzjerje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni gradualisht pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 min. duke hedhur ujë shtesë (nëse nevojitet) gjatë kohës së përzjerjes deri në sasinë maksimale të specifikuar derisa të arrihet konsistenca e kërkuar homogjene pa kokrriza. Për mikse më të mëdha, koha e përzjerjes mund të zgjatet (deri në 5 minuta ose sa nevojitet) derisa llaçi të jetë përzierë në mënyrë homogjene pa kokrriza apo mbetje pluhuri të thatë. Për rezultate më të mira përzieni thasë të plotë. 25 kg pluhur Sika MonoTop®-627 HP përzihet me 3.3 - 3.9 lt ujë në varësi të konsistencës së kërkuar.

APLIKIMI

Sika MonoTop®-627 HP mund të aplikohet manualisht me teknika tradicionale ose mekanikisht duke përdorur pajisje spërkatjeje të lëngët.

Përdorim pa prajmer

Lagni paraprakisht të gjithë nënshtresën e përgatitur, rekomandohet 2 orë përpara aplikimit të Sika MonoTop®-627 HP. Mbani sipërfaqen e lagur dhe mos lejoni të thahet. Përpara aplikimit largoni ujin e tepruar p.sh. me sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë paraqitje mat të errët dhe pa shkëlqim ose tharje e ngopur e sipërfaqes (saturated surface dry, SSD) dhe porët apo vrimat mbi sipërfaqe nuk duhet të përmbajnë ujë. Gjatë aplikimit manual, aplikoni në fillim veshjen fillestare duke hedhur me forcë llaçin riparues mbi sipërfaqen e nënshtresës për të formuar një shtresë të hollë dhe për të mbushur porët dhe vrimat e sipërfaqes. Sigurohuni se e gjithë sipërfaqja që do të riparohet është mbuluar nga veshja fillestare. Aplikoni Sika MonoTop®-627 HP me mallë për riparimet e vogla (riparime betoni, dekorime, skaje shtyllash, etj.) mbi nënshtresën e cila është lagur (siç referohet më sipër), duke ushtruar presion të madh dhe duke ngjeshur llaçin mirë mbi nënshtresën. Mbushni të gjitha hapësirat prapa shufrave të armimit. Shtresëzimi i shtresave nis nga fundi në krye duke ngjeshur llaçin mirë mbi zonën që do të riparohet. Për mbulimin e sipërfaqeve të mëdha, aplikimi mund të kryhet me spërkatje të lëngët me makineri

standarde spërkatjeje (p.sh. Turbosol, Putzmeister). Gjatë spërkatjes sigurohuni se llaçi mbulon të gjithë sipërfaqen e shufrave të armimit dhe nuk lë hapësirë bosh prapa tyre. Në rast intervalelesh ndërprerjeje të punimeve, mos ndaloni makinerinë e spërkatjes për më tepër se 10 min. sidomos në rastet e temperaturave të nxehta. Në këtë rast, vazhdoni me pastrimin e tubacioneve dhe pajisjes.

Përdorim në kombinim me prajmer

Mbi një nënshtresë të përgatitur mirë dhe të ashpërsuar, në përgjithësi nuk kërkohet prajmer, por për këtë produkt rekomandohet gjithmonë. Prajmeri duhet të aplikohet mbi një sipërfaqe paraprakisht të lagur dhe aplikimi vijues i Sika MonoTop®-627 HP duhet bërë i lagësht mbi të lagësht me prajmerin. Kur kërkohet prajmer (sidomos kur shufrat te armimit kanë nevojë për mbrojtje kundër korrodimit), referohuni tek Informacionet mbi Sistemin për produkte kompatibël Sika dhe referohuni tek skeda teknike përkatëse për udhëzime.

Mbrojtja kundër korrodimit të armaturës:

Aty ku kërkohet veshje për përforcimin (p.sh. Sika MonoTop®-910 ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®) referohuni tek Informacionet mbi Sistemin dhe tek skeda teknike përkatëse për informacione më të detajuara. Në përgjithësi, aplikoni llaçin për mbrojtje kundër korrodimit në dy shtresa duke përdorur teknikën me 2 furça ose pistoletë me hinkë mbi armaturën (një shtresë me trashësi ~1mm). Aplikoni shtresën e parë mbi armaturën e ekspozuar. Prisi derisa shtresa e parë të jetë e fortë në prekje me thoin e gishtit në mënyrë që të mos fshihet gjatë aplikimit të shtresës së dytë. Aplikoni shtresën e dytë mbi armaturën e veshur dhe mbi nënshtresën rrethuese të betonit që do të riparohet. Aplikoni Sika MonoTop®-627 HP kur shtresa e dytë e shtresës mbrojtëse kundër korrodimit është ende e lagësht (e lagësht mbi të lagësht).

Shtresëzimi:

Trashësia e shtresës së aplikuar duhet të jetë midis 1.5 dhe 8.0 cm për aplikimet manuale. Mund të arrihen trashësi më të mëdha ose me spërkatje të lëngët ose me shtresëzim manual të shtresave vijuese. Shtresa e parë duhet të ngurtësohet dhe duhet të përfundojë reaksioni ekzotermik i materialit (~10-15 minuta sipas temperaturës së ambientit). Shtresa e 1-rë duhet të fillojë të mpikset dhe të jetë në temperaturë ambienti përpara aplikimit të shtresës së dytë. Mos niveloni shtresën e parë përpara aplikimit të shtresës së dytë. Shtresa e parë duhet të pastrohet me ujë në presion të ulët ose ajër të kompresuar përpara aplikimit të shtresave vijuese të llaçit.

Përfundimi:

Sipërfaqja mund të finirohet sipas kërkesave me mistri suvatimi ndërsa është e lagësht ose me mallë sapo llaçi të fillojë të ngurtësohet.

METODA E MATURIMIT

Mbroni llaçin e freskët të aplikuar nga dehidratimi i hershëm dhe/ose tharja e parakohshme duke përdorur metodat përkatëse të trajtimit (të paktën për 24 orë), p.sh. përbërës trajtimi si Sika® Antisol® ose SikaFloor® Proseal sapo të ketë avulluar uji mbi sipërfaqe. Përdorni mbulesa të përshtatshme trajtimi si jutë dhe ujë, fleta plastike ose membrana të tjera të përshtatshme.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për punimet e meremetimit të betonit referohuni tek Sika "Method of Statement" për "Riparimin e betonit me llaçet Sika® gati për përdorim" (Ref. 8503201) për më tepër informacione rreth aplikimit të sistemit të meremetimit, përgatitjen e sipërfaqes dhe/ose referohuni tek rekomandimet e dhëna tek EN 1504-10

KUFIZIME

- Mos shtoni ujë më shumë se doza e rekomanduar
- Mos shtoni çimento apo substanca të tjera që mund të ndikojnë në cilësinë e llaçit
- Mos shtoni ujë ose llaç të freskët tek llaçi i cili ka filluar të mpikset
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ose erë të fortë
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura
- Pas aplikimit mbroni llaçin nga ngrirja dhe shiu
- Mos hidhni ujë shtesë gjatë përfundimit të sipërfaqes pasi do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje
- Për aplikime vertikale mos tejkaloni trashësi shtrese prej 50 mm për aplikim manual dhe 60mm për aplikim me spërkatje
- Regjistroni temperaturat e ambientit dhe mjedisit përpara dhe gjatë aplikimit

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika MonoTop®-627 HP

Mars 2019, Botimi 01.01

020302040030000142

SikaMonoTop-627HP-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf